



Viti i XVI-të i Botimit, Nr.2

Dhjetor 2024

ANALIZA E VEPRËS PENALE TË FALSIFIKIMIT TË LETËRNJOFTIMEVE, PASAPORTAVE OSE VIZAVE SIPAS LEGJISLACIONIT PENAL SHQIPTAR

Mirgen Preçe*

**Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko- Administrative, Fakulteti i Shkencave Shoqërore,
Albanian University.*

Përmbledhje

Punimi analizon figurën e veprës penale të falsifikimit të letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave duke pasqyruar dhe mënyren se si është zbatuar në praktikën gjyqësore shqiptare kjo figurë e veprës penale. Në punim do të pasqyrohet evolucioni historik për këtë figurë të veprës penale sipas legjislacionit penal shqiptar. Do të bëhet një analizë krahasimore e kësaj figure të veprës penale me figurat e veprave penale të cilat janë parashikuar në legjislacionin penal të disa shteteve anëtare të Bashkimit Europian. Do të analizohet dallimi midis figurës së veprës penale të falsifikimit të letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave me figura të tjera të parashikuara nga Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë. Pyetjet kërkimore të cilave do t'u jepet përgjigje në punimin shkencor janë: Është zbatuar drejtë kjo figurë e veprës penale në jurisprudencën penale shqiptare? Çfarë dallimesh ekzistojnë midis veprës penale perkatëse të parashikur nga Kodi Penal shqiptar dhe legjislacioni penal i vendeve të BE-së? Ka nevojë për ndryshime legislative në legjislacionin penal shqiptar për këtë veper penale? Punimi mbështetet te metodat historike, analitike dhe krahasimore.

Fjalë çelës: *Falsifikim, letërnjoftim, vizë, veper penale.*

ANALYSIS OF THE CRIMINAL OFFENSE OF FORGERY OF LETTERS, PASSPORTS OR VISAS ACCORDING TO ALBANIAN CRIMINAL LEGISLATION

Abstract

Analysis of the criminal offense of forgery of letters, passports or visas according to Albanian criminal legislation. The paper analyzes the form of the criminal offense of forgery of letters, passports or visas, reflecting the way in which this form of criminal offense has been implemented in Albanian judicial practice. The paper will reflect the historical evolution of this form of criminal offense according to Albanian criminal legislation. A comparative analysis will be made of this figure of the criminal offense with the figures of the criminal offenses which are provided in the criminal legislation of some member states of the European Union. The difference between the form of the criminal offense will be analyzed falsification of letters, passports or visas with other images provided by the Criminal Code of the Republic of Albania. The research questions that will be answered in the scientific paper are: Is this figure of the criminal offense correctly implemented in the Albanian criminal jurisprudence? What differences exist between the relevant criminal offense provided by the Albanian Penal Code and the criminal legislation of the EU countries? Is there a need for legislative changes in the Albanian criminal legislation for this criminal offense? The work is based on historical, analytical and comparative methods.

Key words: *Forgery, letter notification, visa, criminal offense.*

I. Vështrim historik

Në Kodin Penal të vitit 1928, në nenin 315, ishte parashikuar prodhimi, ndryshimi ose përdorimi i letërnjoftimeve të falsifikuara, letër lejimet, letra kalimet dhe pasaportat. Po në këtë dispozitë ishte parashikuar edhe ndryshimi i dokumenteve të përmendura më sipër, me qëllim që personi t'i tregojë si të një personi tjetër ose kur janë redaktuar në vende ose në kohë të ndryshme, nga ato për të cilat janë redaktuar.

Në nenin 316 është sanksionuar rrethana e “mbajtjes” së dokumenteve të falsifikuara në formën indirekte, sepse ishte parashikuar se kushdo që kur merr letërnjoftim, letër lejim, leje kalim ose pasaporta, dhe i atribuon vetes në këto emër ose mbiemër ose cilësi të rreme.

Në nenin 317 kanë qenë parashikuar rastet kur vepra penale është kryer nga nëpunës të shtetit që në kohën e ushtrimit të funksionit të tyre kryenin ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenet 315 dhe 317 të Kodit Penal.

Kodi Penal i vitit 1952, i cili normohej nga ligji nr. 1470 datë 23.05.1952, çështjen e falsifikimit të pasaportës, letërnjoftimit apo të çdo dokumenti tjetër, e trajton në dy dispozita, konkretisht në nenin 250 dhe 251. Në nenin 250, të titulluar “Falsifikimi i dokumentave”, është parashikuar falsifikimi i pasaportës, letërnjoftimit, biletës ushtarake ose i çdo dokumenti tjetër veçanërisht të rëndësishëm dëhohet, me burgim nga një vit deri në pesë vjet. Si rrethana rënduese ishin parashikuar, “falsifikimi më shumë se një herë” ose “shitja e dokumentave falco si mjeshteri”, dënohen nga tre deri në tetë

vjet.

Në nenin 251, ishte parashikuar rrethana e mbajtjes dhe përdorimi i dokumentave të falsifikuara. Neni 251 titullohet, “vënia në dorë dhe përdorimi i dokumentave fallco”, ku parashikohej se “vënia në dorë e dokumentave fallco me qëllim përdorimi si dhe përdorimi i tyre ose përdorimi i dokumentave të një tjetri, dënohen me punë korektondëse ose me heqje lirie deri në dy vjet”.

Kodi Penal i vitit 1977 nuk parashikonte në mënyrë eksplicite falsifikimin e pasaportave, letërnjoftimeve ose vizave, por duke parashikuar falsifikimin e dokumenteve, aty përfshiheshin dhe pasaportat, letërnjoftimet ose vizat. Neni 121 i titulluar “Falsifikimi i dokumenteve ose vënia në dorë e tyre me qëllim përdorimi”, parashikonte se “Përvetesimi, shitja, falsifikimi ose vënia në dorë me qëllim përdorimi e dokumenteve zyrtare ose përdorimi i dokumenteve të tilla që i përkasin një tjetri, edhe në qoftë se është kryer më shumë se një herë, dënohet me riedukim nëpërmjet punës ose heqje te lirisë gjër në pesë vjet”.

II. Analizimi i veprës penale të falsifikimit të letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave

II.1 Objekti

Objekti i kësaj figure të veprës penale janë marrëdhëniet juridike që kanë të bëjnë me mënyren e rregullt të lëshimit, përdorimit të letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave.

II.2 Ana objektive

Neni 26 i Ligjit 10 129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, e përkufizon letërnjoftimin si dokumentin bazë të përherëshëm për identifikimin e shtetasve.

Me pasaportë kuptojmë dokumentin e identifikimit që përdoret për të udhëtuar jashtë vendit. Me pasaportë do të kuptohen jo vetëm pasaportat e udhëtimit që përdoren nga shtetasit e ndryshëm, por edhe pasaportat e shërbimit dhe pasaportat diplomatike.

Me vizë do të kuptohen jo vetëm dokumentet e përmendura nga Kreu III, të titulluar “Vizat”, të parashikuara në Ligjin 79/2021, “Për të huajt”, por edhe vizat e falsifikuara të cilat janë lëshuar nga shtetet e huaja të cilat përdoren nga shtetas të ndryshëm për të hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë, psh. siç është rasti i vizave të vendeve anëtare të zonës Shengen.

Sipas paragrafit të parë të nenit 189 të Kodit Penal, është pjesë e anës objektive të veprës, falsifikimi ose përdorimi i letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave të falsifikuara.

Falsifikimi mund të kryhet në dy mënyra: nëpërmjet falsifikimit dhe/ose përdorimit nga personi që kryen falsifikimin e dokumentit ose kur autori përdor dokumentin e falsifikuar nga një person tjetër.

Falsifikimi mund të realizohet në dy mënyra: kur autori bën ndryshime të ndryshme ose shtesa të ndryshme të paligjshme në një letërnjoftim, pasaportë ose vizë ekzistuese dhe në këtë rast jemi përpara falsifikimit material ose kur ndryshohet përmbajtja e dokumentit të falsifikuar, dhe në këtë rast jemi përpara falsifikimit intelektual.

Falsifikimi është veprë formale, pra konsumimi i veprës penale realizohet kur kryhet fakti penal, dhe për këtë arsye kjo është një veprë penale formale.

Në doktrinën e huaj është elaboruar teoria e përjashtimit nga përgjegjësia penale kur jemi përpara situatave të falsifikimit trashanik, kur falsifikimi është realizuar shumë keq dhe në këtë rast nuk mund

të gënjejhet askush për vërtetësinë e dokumentit¹.

Në lidhje me përdorimin e lejes së qëndrimit të falsifikuar në praktiken gjyqësore ka pasur dy qëndrime: Mbështesit e teorisë së pare janë të mendimit se vepra duhet cilësuar sipas nenit 189 të Kodit Penal sepse leja e qëndrimit është e njëjtë me vizën dhe të dyja shërbejnë për të qëndruar në një shtet të caktuar. Përfaqësuesit e teorisë së dytë janë të mendimit se vepra penale duhet të cilësohet sipas nenit 186 të Kodit Penal sepse leja e qëndrimit nuk është vizë, lejeqëndrimi apo pasaportë dhe për këtë arsye cilësimi duhet të bëhet sipas figurës së veprës penale të , “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

Me i drejtë është qëndrimi i mbajtur sipas teorisë së dytë, për arsye se, në Ligjin 79/2021, “Për të huajt”, bëhet dallimi midis vizës dhe lejes së qëndrimit, ku leja e qëndrimit ka kohëzgjatje më të madhe se sa viza dhe është e ndryshme nga viza. Nëse ligjvënësi do të kishte dashur që të përfshinte në nenin 189 të Kodit Penal dhe letërnjoftimin ai mund ta përfshinte si element të anës objektive.

Në rastin kur dikush me pasaportën e vlefshme të dikujt tjetër dëshiron të hyjë në territorin shqiptar, cilësimi nuk duhet bërë sipas nenit 189 të Kodit Penal, por sipas nenit 297 të Kodit Penal, “Kalimi i paligjshmen i kufirit shtetëror” sepse nuk kemi asnjë dokument të falsifikuar dhe në këtë rast pasaporta është përdorur si mjet për kalimin e paligjshëm. Ky është dhe qëndrimi që është mbajtur në praktikë².

Në praktikën gjyqësore në mënyrë të gabuar cilësimi është bërë sipas paragrafit të dytë të nenit 189 të Kodit Penal dhe jo sipas paragrafit të parë të nenit 189 të Kodit Penal, kur i pandehuri ka qenë shtetas i huaj dhe dokumentin e falsifikuar e ka marrë në një shtet të huaj³.

Në rastin konkret nuk ka asnjë provë që fakti penal të jetë konsumuar sipas nenit 189 pika 2 e Kodit Penal, në territorin e Republikës së Shqipërisë, sepse shtetasi i huaj e ka marrë pasaportën e falsifikuar jashtë Shqipërisë. Ligji penal shqiptar nuk mund të zbatohet sipas nenit 189 pika 2 e Kodit Penal, sepse rrethana “e kryer në bashkëpunim”, presupozon faktin që veprimet janë kryer në territorin e Republikës së Shqipërisë, kurse në këtë rast falsifikimi është realizuar jashtë territorit shqiptar dhe nuk është kryer ndonje falsifikim në Shqipëri.

Nëse do të aplikohet neni 189 pika 2 e Kodit Penal, do të binte ndesh me parimin e aplikimit të ligjit penal në hapsirë, me nenin 7, shkronja f), e Kodit Penal.

Sipas nenit 7 shkronja f) e Kodit Penal, parashikohet se: Ligji penal i Republikës së Shqipërisë është i zbatueshëm edhe për shtetasin e huaj që jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë kryen në dëm të interesave të shtetit ose të shtetasit shqiptar, sipas pikës f) falsifikimin e vulës së shtetit shqiptar, parave dhe letrave me vlerë shqiptare.

Në rastin konkret, neni 7 shkronja f) e Kodit Penal nuk e përfshin falsifikimin e pasaportës së huaj kur fakti penal është realizuar jashtë territorit shqiptar.

Figura e veprës penale të “Falsifikimit të letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave”, përfshin dhe rrethanat rënduese “në bashkëpunim”, “më shume se një herë”, “ka sjellë pasoja të rënda”, “kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë letërnjoftimin, pasaportën apo vizën”.

1 Bartolomeo Romano, Guida alla parte special del diritto penale, Giuffrè Editore, Milano, 2007, fq.60.

2 Vendimi Nr. 698, date vendimi 21.03.2024, Gjykata e Shkalles se Pare e Juridiksionit te Pergjithshem Tirane.

3 Vendimi Nr. 3653, date 30.01.2024, Gjykata e Apelit e Juridiksionit te Pergjithshem Tirane. Vendimi Nr. 1911 date 19.07.2023, Gjykata e Shkalles se Pare e Juridiksionit te Pergjithshem Tirane.

II.3 Subjekti

Sipas paragrafit të parë subjekti mund të jetë shtetas shqiptar ose i huaj, mjafton që të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe të jetë i përgjegjshëm. Kurse sipas paragrafit të dytë të nenit 189 të Kodit Penal, subjekti është i posaçëm, dhe është personi që ka për detyrë të leshojë letërnjoftimin, pasaportën ose vizën.

II.4 Ana subjektive

Vepra penale kryhet me dashje direkte duke u nisur nga motivet, interesi dhe me qëllimin përfitimi⁴.

III. Falsifikimi i letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave sipas legjislacionit të disa vendeve të BE-së

Në Kodin Penal të Kodit italian në nenin 497 bis, të titulluar “Posedimi dhe prodhimi i dokumenteve të identifikimit të falsifikuara”, parashikon se, “Kushdo që posedon dokument të rremë të vlefshëm për udhëtim jashtë vendit dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Dënimi i përmendur në paragrafin e parë rritet me një të tretën në gjysmë për ata që prodhojnë ose lëshojnë dokumentin e rremë, ose e mbajnë atë jashtë rasteve të përdorimit personal”

Në jurisprudencën e Gjykatës së Kasacionit të Italisë, me vendimin e datës 17.01.22, është mbajtur qëndrimi i përjashtimit nga përgjegjësia penale në rastin e krijimit të dokumenteve false ose ndryshimit të dokumenteve të verteta, nëse falsifikimi është i dallueshëm nga të gjithë dhe nuk është e nevojshme të zhvillohen hetime. Ndonëse kohë më parë qëndrimi ishte se pavarësisht se falsifikimi ishte i dallueshëm nga të gjithë, autori përjashtojë penalisht nga rrethana e mbajtjes së dokumentit të falsifikuar por ishte bashkëpunëtor në lidhje me prodhimin e dokumenteve të falsifikuara, ky qëndrim ishte për të dekurajuar prodhimin e dokumenteve false⁵.

Në lidhje me falsifikimin e letërnjoftimeve ose pasaportave ligjvënësi francez, e ka parashikuar si figurë të veprës penale në nenin 441-8 të Kodit Penal francez, me përmbajtjen e mëposhtme: “Fakti i përdorimit të një dokumenti identiteti ose udhëtimi, një leje qëndrimi ose të ndonjë dokumenti të përkohshëm të përmendur në nenin L. 431-3 të Kodit të Hyrjes dhe Qëndrimit të të huajve dhe të drejtën e azilit që i përket një të treti, me ose pa pëlqimin e tyre, për qëllime të hyrjes, qarkullimit ose qëndrimit në territorin francez ose për të fituar në mënyrë të parregullt një titull, cilësi, status ose avantazh dënohet me pesë vjet burgim dhe gjobë prej 75,000 €.

Me të njëjtin dënim dënohet fakti që mbajtësi i identitetit ose i dokumentit të udhëtimit, i lejes së qëndrimit ose i dokumentit të përkohshëm të përmendur në të njëjtin nen L. 431-3, ka lehtësuar me vetëdije kryerjen e veprës së përmendur në paragrafin e parë.

Dënimet rriten në shtatë vjet burgim dhe gjobë prej 100,000 € kur këto vepra kryhen në mënyrë të vazhdueshme”.

Legjislacioni penal rumun, nuk ka një figurë të veprës penale që të përbletë falsifikimin e letërnjoft-

4 Ismet Elezi, “E drejte penale. Pjesa e posacme”. Botimet Kumi, Tirane, 2016, fq.315.

5 Enrico Michetti, Creazione di documenti d'identita falsi: la falsificazione grossolana esclude la punibilita. <https://www.gazzettaamministrativa.it/servizicu/bancadati/viewnews/3a-09a524440d44d7f19870070a5ad42f>

imit, pasaportës ose vizës, por janë disa dispozita që zbatohen në raport me faktin penal.

Në nenin 327 të Kodit Penal të Rumanisë të titulluar “falsifikimi në lidhje me identitetin”, është parashikuar paraqitja me identitet të rremë ose caktimi i një identiteti të tillë një personi tjetër, i bërë një personi nga ato të parashikuara në nenin. 175, (është fjala për paraqitjen përpara nëpunësit publik) ose i transmetohet një njësie në të cilën ai ushtron veprimtarinë e tij nëpërmjet përdorimit mashtrues të një dokumenti që shërben për identifikimin, identifikimin ose vërtetimin e gjendjes civile ose një dokumenti të tillë të falsifikuar, me qëllim që të mashtrrojë ose mashtrrojë një zyrtar publik, me qëllim që të që prodhohen pasoja juridike, për veten ose për tjetrin, dënohet me burgim nga 6 muaj deri në 3 vjet.

(2) Kur paraqitja është bërë duke përdorur identitetin real të personit, dënohet me burgim nga një deri në 5 vjet.

(3) Besimi i një dokumenti që shërben për identifikim, identifikim ose vërtetim të gjendjes civile për t’u përdorur pa të drejtë dënohet me burgim nga 3 muaj deri në 2 vjet ose me gjobë.

Në nenin 323 të Kodit Penal të Rumanisë të titulluar “falsifikimi material i dokumenteve zyrtare”, është parashikuar dhe përdorimi i dokumenteve të falsifikuara, ku bëjnë pjesë përdorimi i dokumenteve zyrtare të falsifikuara ose përdorimi i shkresave private të falsifikuara, në të dyja rastet bëhet fjalë kur autori e di që dokumentet janë të falsifikuara.

Në doktrinën rumune është bërë dallimi midis falsifikimit material dhe atij intelektual, ku falsifikimi intelektual i referohet përmbajtjes, së dokumentit, dmth. brendisë së tij, kurse falsifikimi material i referohet dokumentit në kuptimin e *instrumentum*⁶.

Nëse dokumenti zyrtar i falsifikuar është realizuar nga nëpunësi publik gjatë ushtrimit të detyrës në përputhje me atributet e tij, cilësimi do të bëhet sipas nenit 321 të Kodit Penal të Rumanisë të titulluar “Falsifikim intelektual”.

Kurse në nenin 320 të Kodit Penal të Rumanisë është parashikuar falsifikimi i dokumenteve zyrtare. Kjo dispozite i referohet situatës kur autori nuk është nëpunësi publik dhe nuk ka kompetenca për të leshuar dokumentet zyrtare.

Duke krahasuar legjisllacionin shqiptar me atë të vendeve të BE-së, vëmë re se sipas legjisllacionit penal shqiptar, “mbajtja ” e dokumentit të falsifikuar pa u shoqëruar me përdorimin nuk është pjesë e figurës së veprës penale si rrethanë e veçantë. Mbajtja dënohet në menyrë indirekte kur dokumenti i falsifikuar përdoret, sepse nuk ka përdorim të dokumentit të falsifikuar pa pasur mbajtje. Në legjisllacionin penal shqiptar para vitit 1990, mbajtja ishte si rrethanë e veçantë dhe duhet parashikuar dhe në legjisllacionin aktual. Në rast se një shtetas i huaj do të kishte marrë jashtë shtetit dhe do të kishte me vete një dokument të falsifikuar pasaportë ose letërnjoftim të cilën nuk e ka përdorur në një rast të tillë ky person duhet të përjashtohet nga përgjegjësia penale sepse fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale, kurse në praktikën gjyqësore⁷ ka ndodhur e kundërta, personi është dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 189 i Kodit Penal.

Duke analizuar legjisllacionin e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, vëmë re se ka dy qëndrime në lidhje me rrethanën e “mbajtjes”. Ka vende që e parashikojnë rrethanën e “mbajtjes”, si pjesë e veprës penale, ka shtete që nuk e parashikojnë në legjisllacionin penal rrethanën e “mbajtjes”.

6 Costica Bulai, Avram Filipaş, Constantin Mitrache, “Instituții de drept penal”, Trei, Bukuresht, 2006, fq. 515-516.

7 Vendimi nr. 1889, date 18.07.2023, Gjykata e Shkalles se Pare e Juridiksionit te Pergjithshem Tirane. Vendimi nr. 165, date 01.02.2024, Gjykata e Shkalles se Pare e Juridiksionit te Pergjithshem Tirane.

Konkluzione:

Duke pasur parasysh përhapjen e madhe të veprës penale të “Falsifikimit të letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave” dhe faktin që ligjvënësi nuk e ka parashikuar rrethanën e “mbajtjes” në paragrafin e parë të nenit 189 të Kodit Penal, është e domosdoshme që kjo rrethanë të përfshihet në nenin 189 të Kodit Penal sepse bën të mundur që të kenë përgjegjësi penale shtetasit e huaj kur vepra është kryer jashtë shtetit. Ky qëndrim është në përputhje dhe me qëndrimin e ligjvënësit deri me hyrjen në fuqi të Kodit Penal aktual, sepse një rrethanë e tillë ka qenë parashikuar në legjislacionet penale të mëparshme.

Në legjislacionin penal duhet përfshirë dhe situata kur një person përdor dokumentet e rregullta të dikujt tjetër, në një situatë të tillë, jemi përpara falsifikimit të identitetit. Një veper e tillë është e parashikuar edhe në legjislacionin penal të vendeve të Bashkimit Evropian.

Referecë:

1. **Bartolomeo Romano**, “Guida alla parte special del diritto penale”. Giuffrè Editore, Milano, 2007.
2. **Costica Bulai, Avram Filipaş, Constantin Mitrache**, “Instituții de drept penal”. Trei, Bukuresht, 2006.
3. **Ismet Elezi**, “E drejte penale. Pjesa e posacme”. Botimet Kumi, Tirane, 2016.
4. Vendimi Nr. 698, date vendimi 21.03.2024, Gjykata e Shkalles se Pare e Juridiksionit te Pergjithshem Tirane.
5. Vendimi Nr. 3653, date 30.01.2024, Gjykata e Apelit e Juridiksionit te Pergjithshem Tirane.
6. Vendimi Nr. 1911 date 19.07.2023, Gjykata e Shkalles se Pare e Juridiksionit te Pergjithshem Tirane.
7. Vendimi nr. 1889, date 18.07.2023, Gjykata e Shkalles se Pare e Juridiksionit te Pergjithshem Tirane.
8. Vendimi nr. 165, date 01.02.2024, Gjykata e Shkalles se Pare e Juridiksionit te Pergjithshem Tirane.
9. **Enrico Michetti**, Creazione di documenti d’identita falsi: la falsificazione grossolana esclude la punibilita. <https://www.gazzettaamministrativa.it/servizicu/bancadatigari/viewnews/3a-09a524440d44d7f19870070a5ad42f>